



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

V E N D I M

Nr. 516, Datë 05.10.2023

PËR

RENDITJEN E KANDIDATËVE NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRËN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 185, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me datë 05.10.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, për gatitur nga relatorja e procedurës së përzgjedhjes znj. Marçela Shehu,

V Ë R E N:

I. TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si Këshilli) pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji¹, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), në kuadër të plotësimit të pozicioneve të

¹ Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” i ndryshuar; Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”; Vendimi nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, ndër të tjera, ka hapur dhe disa procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, respektivisht me Vendimet e tij nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020 dhe nr. 396 datë 07.10.2020.

2. Në procedurat e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale si më lart, brenda afatit të kandidimit, kandiduan gjithsej njëmbëdhjetë kandidatë dhe konkretisht: z. {...}; znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}. Përfundimisht, kandidimet e gjyqtarëve, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë paraqiten në formë tabelare si më poshtë:

Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 184, datë 28.05.2020	Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 185, datë 28.05.2020	Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 396², datë 07.10.2020
{...}	{...}	{...} ⁸
{...} ³	{...}	{...}
{...}	{...}	{...} ⁹
{...} ⁴	{...} ⁵	{...} ¹⁰

² Këshilli, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për këtë pozicion të lirë, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, me Vendimin e tij nr. 154 datë 20.04.2022 ka vendosur : “Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të znj. {...}”.

³ znj. {...} e cila kishte kandiduar edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 181, datë 28.05.2020, Këshilli, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për këtë pozicion të lirë, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, me Vendimin e tij nr. 167 datë 05.05.2022 ka vendosur : “Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të znj. {...}”.

⁴ znj. {...}ju tërhoq nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 184, shkak për të cilin Këshilli me Vendimin nr. 110, datë 25.03.2022 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

⁵ znj. {...} e cila kishte kandiduar edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 182, datë 28.05.2020, Këshilli, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për këtë pozicion të lirë, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, me Vendimin e tij nr. 592 datë 23.12.2021 ka vendosur : “Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të znj. {...}”.

⁸ znj. {...}ju tërhoq nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 396, shkak për të cilin Këshilli me Vendimin nr. 110, datë 25.03.2022 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

⁹ znj. {...} u tërhoq nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 396, shkak për të cilin Këshilli me Vendimin nr. 350, datë 09.09.2021 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

¹⁰ znj. {...} u tërhoq nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 396, shkak për të cilin Këshilli me Vendimin nr. 302, datë 13.07.2021 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

	{...} ⁶ {...} {...} ⁷	
--	---	--

3. Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve *që përmbushin kriteret*, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

4. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriteve të mëposhtme:

- 1) *“përvojës profesionale minimale”*, sipas shkronjës “b”, pika 4, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “4. *Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*
- 2) *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “8. *Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”;*
- 3) *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “1. *Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave*

⁶ znj. {...} e cila kishte kandiduar edhe për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e tij nr. 120, datë 01.04.2021, Këshilli, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për këtë pozicion të lirë, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, me Vendimin e tij nr. 593 datë 23.12.2021 ka vendosur : “Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}”.

⁷ znj. {...} ju tërhoq nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 185, shkak për të cilin Këshilli me Vendimin nr. 110, datë 25.03.2022 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkohet të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”;

- 4) *të pasurisë dhe figurës*, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji”, si dhe: “8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

5. Me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, Këshilli ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, pikërisht atyre të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kriteret do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

6. Për kandidatët¹¹ që vijuan në garë në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin nga ata të gjithë kriterëve të kandidimit, duke

¹¹ Dy nga kandidatët, znj. {...} dhe znj. {...} u tërhoqën nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 396, shkak për të cilin Këshilli ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këta kandidatë.

vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave respektive të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira ku kanë kandiduar. Konkretisht:

- 1) *Për z. {...}*, i cili ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, Këshilli, me Vendimin nr. 54, datë 16.02.2021, ka vendosur kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;
- 2) *Për znj. {...}*, e cila ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 184 datë 28.05.2020, kandidatë për të cilën Këshilli, me Vendimin nr. 453, datë 19.10.2020, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;
- 3) *Për z. {...}*, i cili ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, Këshilli, me Vendimin nr. 269, datë 28.06.2021, ka vendosur kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;
- 4) *Për znj. {...}*, e cila ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020 dhe nr. 396 datë 07.10.2020, Këshilli, me Vendimin nr. 169, datë 22.04.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;
- 5) *Për znj. {...}*, e cila ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, Këshilli, me Vendimin nr. 170, datë 22.04.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;
- 6) *Për znj. {...}*, e cila ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr. 392 dhe nr. 395, datë 07.10.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 396 datë 07.10.2020, Këshilli, me Vendimin nr. 525, datë 10.11.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

- 7) *Për znj. {...}*, e cila ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr. 181 dhe nr. 183 datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, Këshilli, me Vendimin nr. 649, datë 29.12.2020, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;
- 8) *Për znj. {...}*, e cila ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 181 dhe nr. 182 datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 396 datë 07.10.2020, Këshilli, me Vendimin nr. 205, datë 20.05.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;
- 9) *Për znj. {...}*, e cila ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 182 dhe nr. 183 datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 185 datë 28.05.2020, Këshilli, me Vendimin nr. 169, datë 22.04.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;
- 10) *Për znj. {...}*, e cila ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 394 dhe nr. 395, datë 7.10.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 396¹², datë 7.10.2020, Këshilli, me Vendimin nr. 268, datë 28.06.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë; në vijim ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021 dhe Këshilli, me Vendimin nr. 495, datë 25.10.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

7. Gjatë procedurës së verifikimit, ka rezultuar se kandidatja znj. {...}¹³ u tërhoq nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur

¹² znj. {...} u tërhoq nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 396, shkak për të cilin Këshilli me Vendimin nr. 350, datë 09.09.2021 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë dhe në vijim kandidoi në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021.

¹³ Këshilli me vendimin nr. 625 datë 10.12.2020 kishte vendosur mbi verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë

me vendimin nr. 396, shkak për të cilin Këshilli me Vendimin nr. 302, datë 13.07.2021 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

7.1 Lidhur me kandidaten znj. {...} e cila kishte kandiduar edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 182, datë 28.05.2020, Këshilli, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për këtë pozicion të lirë, me Vendimin e tij nr. 592 datë 23.12.2021 ka vendosur : *“Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të znj. {...}”*.

7.2 Ndërkohë, lidhur me kandidaten znj. {...} e cila kishte kandiduar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 120, datë 01.04.2021, Këshilli, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 120, datë 01.04.2021, me Vendimin e tij nr. 593 datë 23.12.2021 ka vendosur : *“Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2022”*.

7.3 Kandidatja {...} e cila kishte kandiduar edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 181, datë 28.05.2020, Këshilli, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për këtë pozicion të lirë, me Vendimin e tij nr. 167 datë 05.05.2022 ka vendosur : *“Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të znj. {...}”*.

8. Siç u parashtua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) vlerësimi i përsheptuar për vitin 2019, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr. 48/2019.

9. Ndërsa proceset e verifikimit të kriterëve të kandidimit dhe atyre të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurave tërësore të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me Vendimin nr. 56, datë 16.02.2021, Këshilli filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, fillimisht, edhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me Vendimet e tij nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020. Me këtë vendim, si raportore e procedurës së përzgjedhjes për dy pozicionet e

në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin e tij nr. 396, datë 07.10.2020 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

lira në fushën e të drejtës penale u caktua anëtarja e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, znj. Marçela Shehu.

10. Në zbatim të pikës 31, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, kandidatët e kualifikuar deri në atë moment u njoftuan për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë ku kanë kandiduar, si dhe për caktimin e relatores. Kandidatët e kualifikuar më pas, u njoftuan menjëherë pasi Këshilli ka vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë. Nga kandidatët nuk janë paraqitur kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatores apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

11. Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për secilin kandidat të kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikat dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori ka administruar edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatët e kualifikuar.

12. Në situatën si më lart, siç mund të konstatohet, procedura e përzgjedhjes, pra renditja e kandidatëve dhe përzgjedhja e kandidatit të renditur më lart me qëllim ngritjen e tij në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mund të vijojë dhe të përmbillet sa i përket të dyja procedurave të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, në rrethanat kur për kandidatët e këtyre pozicioneve të lira ka përfunduar procedura e verifikimit dhe për ata ka dy vlerësime etike dhe profesionale. Sipas pikës 46, të Vendimit 70/2020: *“Vetëm kandidatët e kualifikuar dhe që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë”,* ndërkohë që sipas pikës 52 të tij : *“Në përfundim të veprimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në një pozicion të lirë, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe projektvendimin për renditjen e kandidatëve”*.

13. Ndaj mbi sa u parashtrua më lart, relatorja e procedurës administroi tërësisht dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përmbjlljes së procedurave të përzgjedhjes sa i përket procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020.

13.1 Për kandidatin z. {...} u administruan edhe dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 59 dhe nr. 60, datë 15.02.2022, vendime të cilët janë përfundimtarë.

13.2 Për kandidatin z. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 341 datë 27.06.2023 dhe nr. 460, datë 25.07.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë.

13.3 Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 557 dhe nr. 560, datë 01.02.2021, vendime të cilët janë përfundimtarë.

13.4 Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 224, datë 08.05.2023 dhe nr. 459, datë 25.07.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë.

14. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV (*Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve*), të Vendimit 70/2020, relatorja realizoi renditjen e kandidatëve për secilin nga dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura nga Këshilli me vendimet nr. 184 dhe nr. 185 datë 28.05.2020 për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke ndjekur rendin kronologjik të shpalljes së tyre.

15. Lidhur me renditjen e kandidatëve nga Këshilli u mbajt në konsideratë pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh: i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi; ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor; b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë; c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës "b", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist”.*

16. Po ashtu, për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të Vendimit 70/2020, dalë në zbatim të pikës 14, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“14. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë: “a) kriteret për vlerësimin*

ndërmjet kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi etik dhe profesional; b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë; c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta; ...”.

II. RENDITJA E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 185, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

17. Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020, përfundimisht u përfshinë katër kandidatë, konkretisht: znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; z. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjës për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në shkronjën “c”, pika 7 dhe në pikën 46, të Vendimit 70/2020.

18. Edhe në këtë procedurë përzgjedhjeje, për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B, Kreu IV, të Vendimit 70/2020.

18.1 Referuar kriterit të parë të renditjejes, atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

- a) Për z. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 341, datë 27.06.2023, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*”;
- Sipas Vendimit të Këshillit nr. 460, datë 25.07.2023, kandidati është vlerësuar për vitin 2019-2020 në nivelin e përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*”;
- b) Për z. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 59, datë 15.02.2022, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*”;
- Sipas Vendimit të Këshillit nr. 60, datë 15.02.2022, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “*Shumë mirë*”.

- b) Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 557, datë 1.12.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “*Shumë mirë*”;
- Sipas Vendimit të Këshillit nr. 560, datë 01.12.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “*Shumë mirë*”.
- c) Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 224, datë 08.05.2023, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*”;
- Sipas Vendimit të Këshillit nr. 459, datë 25.07.2023, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019-2020, në nivelin e përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*”.

18.2 Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “*niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale*”, rezultoi që dy kandidatë, konkretisht z. {...} dhe znj. {...} të kenë “*Shkëlqyeshëm*” të dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Ndërsa, kandidati z. {...} dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “*Shkëlqyeshëm*” dhe “*Shumë mirë*” dhe znj. {...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “*Shumë mirë*”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke patur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin¹⁴, identifikohen dy kandidatë me rezultate më të larta, konkretisht kandidatët {...} dhe znj. {...}, që renditen më lart se kandidatët z. {...} dhe znj. {...}.

18.3 Referuar rezultatit të renditjes së kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020, në kushtet kur kandidati {...} renditet i pari në këtë procedurë, rezulton se është rrjedhimisht dhe kandidati potencial i mundshëm për t’u ngritur në detyrë në këtë pozicion. Në këto kushte

¹⁴ “1. Vlerësimi i magjistratit kryhet sipas këtyre niveleve:

- a) “*Shkëlqyeshëm*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta;
b) “*Shumë mirë*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren;
c) “*Mirë*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare;
ç) “*Mjaftueshëm*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren.
d) “*I pamjaftueshëm*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët. ...”.

duhet identifikuar kandidati tjetër, përveç kandidatit {...}, që do të duhet të renditet i pari për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020.

19. Nisur nga përcaktimet e Vendimit 70/2020, ndërsa nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas *“niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”*, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, pikërisht znj. {...}. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020, konkretisht si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Z. {...};
- 3) Znj. {...}.

20. Kandidatja e renditur më lart në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020, pavarësisht kandidimit edhe për pozicione të tjera të lira për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet që, në momentin e kandidimit, të ketë shprehur preferencë kandidimi të parë pikërisht pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020, sikurse përcaktohet në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin ku thuhet : *“Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës”*. Për pasojë, për këtë kandidate është e zbatueshme dhe preferenca e kandidimit.

21. Bazuar në sa përcaktohet më sipër, sikundër edhe në rezultatin e renditjes të këtij vendimi, relatorja përgatiti projektvendimin *“Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”* i cili u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 25.09.2023, sikurse përcaktohet në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, duke vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

22. Projektvendimi *“Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*, si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Seksionin Ç, Kreu VI, të Vendimit 70/2020.

23. Gjatë shqyrtimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatorja, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar për kandidatët në funksion të renditjes së tyre.

III. KONKLUZIONI

24. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 86, 97 dhe 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 10 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”,

V E N D O S I:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:
 1. Znj. {...};
 2. Z. {...};
 3. Znj. {...}.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR